

Mbledhja e datës 1 prill 2019

Grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, në drejtimin e Kryetarit të Kuvendit dhe Kryetar i Grupit, Z. Gramoz Ruçi, në mbledhjen e sotme, shqyrtoi Raportin e pestë periodik mbi zbatimin e Konventës së OKB për të drejtat e fëmijëve. Në mbledhje merrnin pjesë përveç deputetëve anëtarë të Grupit, edhe përfaqësues të institucioneve shtetërore, organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile, që trajtojnë problemet e fëmijëve.

Raporti u prezantua nga Znj. Artemis Dralo, Zv. Ministre për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Znj. Ogerta Manastirliu, Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në takim diskutoi edhe përfaqësuesi i zyrës së UNICEF-it në Shqipëri, Dr. Roberto De Bernardi, i cili u shpreh se “Të drejtat e fëmijëve të mishëruara në Konventën e të Drejtave të Njeriut tridhjetë vite më parë mbeten të njëjta, por bota ku fëmijët jetojnë po ndryshon vazhdimisht. Të gjithë ne kemi për detyrë t’i mbështesin fëmijët, qoftë si profesionistë apo qytetarë, që të njohin dhe realizojnë të drejtat e tyre, duke marrë gjithnjë Konventën si standard për të matur progresin e shënuar. Mbledhja shërben për të pasqyruar rrugëtimin e vazhdueshëm në të cilin Qeveria e Shqipërisë duhet të angazhohet për të arritur sukses në këtë drejtim”.

Grupi i deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” ka punuar dhe vazhdon të punojë për zhvillimin dhe ndërmarrjen e politikave të vazhdueshme në mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës. Nëpërmjet ligjbërjes dhe ushtrimit të kontrollit parlamentar është kujdesur të nxisë dhe të mbikëqyrë rritjen e standarteve në kujdesin shëndetësor, arsimor, shërbimet ligjore, sociale e publike në shërbim të fëmijëve.

Në përfundim të mbledhjes, Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, i rekomandoi Grupit Ndërministror të Punës për përpilojë një listë të iniciativave ligjore, për të cilat Ministrinë e Linjës dhe Grupi Miqtë e Fëmijëve duhet të bashkëpunojnë për t’u realizuar në dy vitet e ardhshme dhe të planikojë seancën e dëgjësës speciale për Raportimin e Zbatimit Afatmesëm të Agjendës kombëtare të fëmijëve.